



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**UDHËZUES PËR ZBATIMIN E
PROGRAMIT TË LEXIM-SHKRIMIT**

Tiranë 2017



Për zbatimin e programit, MASR- ja ngarkon QSHA-në, IZHA-n, DAR/ZA-të dhe shkollat. Më poshtë janë përcaktuar detyrat e institucioneve të mësipërme.

MASR:

- të koordinojë veprimtaritë mes institucioneve: QSHA, IZHA dhe DAR/ZA;
- të përcaktojë kostot financiare në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve dhe me zbatimin e programit.

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA):

- të hartojë dhe ta shpërndajë në DAR/ ZA-të databazën e nxënësve që në vlerësimet e saj, kanë dëshmuar arritje të ulëta në lexim- shkrim;
- të bashkëpunojë me IZHA-n për hartimin e programit të lexim- shkrimit;
- të hartojë testin që do të masë arritjet e nxënësve, në përfundim të zbatimit të programit;
- të hartojë raportin me konkluzione dhe rekomandime për vazhdimësinë e mëtejshme në lidhje me arritjet e nxënësve në lexim- shkrim.

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA):

- të hartojë në bashkëpunim me QSHA-në programin e lexim- shkrimit;
- të trajnojë mësuesit që do të zbatojnë programin e lexim- shkrimit;
- të bashkëpunojë me QSHA- në hartimin e testit në përfundim të programit të lexim- shkrimit.

Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR):

- të bashkëpunojë me QSHA- në për databazën e nxënësve, të cilët kanë pasur arritje të ulëta në testimin kombëtar të zhvilluar në datën 10.10.2017;
- të bashkëpunojë me drejtoritë e shkollave që të krijohen kushtet për zbatimin e programit;
- të përcaktojë në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, mësuesit që do të zbatojnë programin e lexim- shkrimit. Mësuesit duhet të jenë të ciklit fillor.
- të monitorojë procesin e zbatimit të programit në shkollë;
- të raportojë në MASR (*çdo muaj*) për ecurinë dhe problematikat që do të dalin gjatë zbatimit të programit.

Stafi drejtues i shkollës:

- të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në lexim- shkrim;

- në bashkëpunim me mësuesit t'i grupojë nxënësit në dy grupe. Në grupin e parë do të përfshijë nxënësit që nuk njohin shkronjat e alfabetit, ndërsa në grupin e dytë do të përfshihen nxënësit që i njohin shkronjat, por nuk lexojnë rrjedhshëm dhe kuptueshëm. Grupi i parë do të zhvillojë të dyja modulet, ndërsa grupi i dytë do të zhvillojë vetëm modulën e dytë;
- të përcaktojë vendin dhe kohën ku do të zhvillohet mësimi;
- të përzgjedhë mësuesin/ mësuesit që do të zbatojnë programin;
- të krijojë mundësi, në bashkëpunim me prindërit, me bordin e shkollës, me këshillin e prindërve etj., për sigurimin e bazës materiale (*tekste, mjete mësimore etj.*);
- të mbështesë dhe të monitorojë gjithë procesin e zbatimit të programit.

Mësuesit:

- të njohin dhe të zbatojnë kërkesat e programit të lexim- shkrimit;
- të dokumentojnë në një regjistër ose evidencë të veçantë, frekuentimin dhe arritjet e nxënësve;
- të përzgjedhin materialet mësimore me të cilat do të punojnë nxënësit;
- të bashkëpunojnë me stafin drejtues të shkollës dhe me prindërit për ecurinë e nxënësve në këtë program.